



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2172/2 Prot.

Tiranë, më 22.09.2025

VENDIM

Nr. 46 Datë 22.09.2025

**“PËR
MIRATIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË
PÛRKOHSHME STAF AKADEMIK PËR TRE NJËSITË KRYESORE TË
UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS,
PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026”**

Në zbatim të Ligjit nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë" nenit 49, pika 1, gërma (ç), në VKM me nr.123, datë 17.02.2010 "Për krijimin e Universitetit të Sporteve të Tiranës", në Statutin e UST-së neni 43, gërma II), në VKM me nr. 243, datë 20.04.2023 "Për një ndryshim në VKM nr. 748, datë 11. 06. 2009 të Këshillit të Ministrave "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të Arsimit të Lartë, në VKM me nr. 329, datë 12.04.2017 "Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik", në Udhëzimin e MASR me nr. 29, datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet publike të Arsimit të Lartë", në shkresën e Dekanit të Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes me nr. 2008/1 prot., datë 12.09.2025 "Kërkesë për personel akademik të jashtëm për vitin akademik 2025-2026 në FSHL", në shkresën e Dekanit të Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit me nr. 2008/3 prot., datë 15.09.2025 "Planifikimi për personel akademik me kohë të pjesshme pranë FVFR, për vitin akademik 2025-2026", në shkresën e Dekanit të Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit me nr. 2008/2 prot., datë 12.09.2025 "Planifikimi për personel akademik me kohë të pjesshme për vitin akademik 2025-2026", në FSHR-së", bazuar në Vendimin Qarkullues të Rektoratit nr.101 datë 17.09.2025 "Për miratimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme staf akademik për tre njësitë kryesore të Universitetit të Sporteve të Tiranës, për vitin akademik 2025-2026", në Vendimin Qarkullues të Senatit Akademik nr 108 datë 17.09.2025, si dhe në relacionin e administratorit nr 2154 prot dt 18.09.2025, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 22.09.2025,

V E N D O S I :

1. Miratimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme staf akademik për tre njësitë kryesore të Universitetit të Sporteve të Tiranës, për vitin akademik 2025-2026, si më poshtë:

- Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme staf akademik FSHL 13 persona
 - Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme staf akademik FVFR 6 persona
 - Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme staf akademik FSHR 14 persona
2. Efektet financiare të mbulohen nga të ardhurat dytësore të Universitetit të Sporteve të Tiranës.
 3. Ngarkohen për zbatimin e këtij Vendimi Administratori, Njësitë kryesore, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Arkivës, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Universitetin e Sporteve të Tiranës.
 4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen www.ust.edu.al dhe tek transparenca universitare.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Artur COBANI

